

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6868  
E enjte, 6 prill 2023  
çmimi 0.40 €

## Mbi 4 000 aksidente ndodhën në Kosovë brenda tre muajve

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)


facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

MBROJTJA E JAKUP KRASNIQIT PARAQITI FJALËN HYRËSE  
NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË | FAQE 4-5

# MBROJTJA E KRASNIQIT: PROKURORIA S'KA PROVA PËR ZËDHËNËSIN E UÇK-së

**Krasniqi:**  
Në jetën time asnjëherë s'kam kryer ndonjë vepër kriminale, as para luftës, as gjatë luftës e as pas luftës



Gjykata Speciale



Avokatja e Jakup Krasniqi, Venkateswari Alagendra, ka thënë se nuk ka asnjë provë që e ndërlidh zëdhënës të UÇK-së me krimet e pretenduara nga ZPS-ja. Ajo gjatë paraqitjes së fjalës hyrëse në procesin gjyqësor në

Hagë ka thënë se prokuroria e ka keqinterpretuar rolin e Krasniqi në UÇK dhe gjithë organizimin e kësaj ushtrie. Alagendra ka thënë se ZPS-ja duket sikur është bërë pjesë e propagandës kundër UÇK-së. Ndërsa Jakup Krasniqi ka

deklaruar se asnjëherë në jetën e tij nuk ka kryer ndonjë vepër penale. Në këtë kontekst, Krasniqi i ka quajtur "absurde" akuzat se ai, së bashku me të akuzuarit e tjerë, kanë "persekutuar" anëtarë të LDK-së siç pretendon prokuroria

## BORRELLI: KOSOVA DHE SERBIA PAJTOHEN PËR DEKLARATËN E TË PAGJETURVE, KURTI DHE VUÇIQI DO TA MIRATOJNË NË TAKIMIN E ARDHSHËM



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

GJILANI MPOSHI LLAPIN,  
PRISHTINA PËRMBYSI VUSHTRINË

F. 14



**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



SHBA-ja JEP EDHE 2.6 MILIARDË  
DOLLARË NDIHMË USHTARAKE  
PËR UKRAINËN | F. 2

PËRKUJTOHET MASAKRA E  
REZALLËS | F. 6

MUSLIU: ORGANET E SIGURISË  
KANË INFORMACIONE SE NË  
RASHKË PO KRYHEN STËRVITJE  
PËR TA DESTABILIZUAR VERIUN | F. 7

### EKONOMI



HOTI: KËTA QEVERITARË NUK KANË  
LIDHJE ME SHTET DHE ME EKONOMI | F. 8

SINDIKATA E QKUK-së PROTESTON  
PËR PAKËNAQËSITË PËR  
KOEKOFICIENTIN E PAGAVE | F. 8

### SPORT



## ShBA-ja jep edhe 2.6 miliardë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën

WASHINGTON, 5 PRILL - Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë zbuluar hollësi të ndihmës së re ushtarake prej 2.6 miliardë dollarësh për Ukrainën - për ta ndihmuar vendin në luftën kundër forcave ruse. Paketa përfshin shumëllojshmëri municionesh nga rezervat e Pentagonit, të destinuara për të mbërritur shpejt në fushëbetje. Gjithashtu, në paketë përfshihen sisteme raketore të artilerisë me lëvizshmëri të lartë, HIMARS, dhe raketa kundërajrore Patriot - për të ndihmuar në pengimin e goditjeve ajrore ruse të infrastrukturës së Ukrainës. Sipas Pentagonit, në paketë do të ketë edhe armë të vogla dhe

mjete transporti të pajisjeve të rënda, si dhe municione shtesë për sistemet e mbrojtjes ajrore NASAMS. "ShBA-ja do të vazhdojë t'i ofrojë Ukrainës ndihmë ushtarake për t'i përmbushur nevojat e saj të menjëhershme në fushëbetje", thuhet në deklaratën e Pentagonit.

Ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, komentoi paketën para takimit me sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, në selinë e NATO-s në Bruksel. "Ne vlerësojmë shumë gjithçka që Shtetet e Bashkuara kanë bërë, në mënyrë specifike në muajin e fundit, për ta ndihmuar ushtrinë

tonë të përgatitet për kundërsulm", tha ai.

Ambasada ruse në Uashington reagoi ndaj këtij njoftimi dhe akuzoi Shtetet e Bashkuara se duan ta zvarritin konfliktin. "Vendimi për furnizimin e Kievit me armë është një hap drejt përshkallëzimit të krizës ukrainase dhe rritjes së numrit të viktimave civile", citon agjencia TASS një deklaratë të ambasadës.

Armët dhe financimi i ri po bëhen në kohën kur trupat ukrainase përgatiten për një ofensivë pranverore kundër forcave ruse të cilat vazhdojnë ta bombardojnë Ukrainën me raketa me rreze të gjatë.



## Trumpu: Aktakuza ndaj meje, ndërhyrje në zgjedhjet e ardhshme



WASHINGTON, 5 PRILL - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, e quajti aktakuzën si sulm ndaj tij dhe si betejë e fundit me drejtësinë. Kështu deklaroi ai në rezidencën e tij Mar-a-Lago në Florida, gjatë deklarimit për medie. "Ky rast i rremë [aktakuza] u ngrit vetëm për të ndërhyrë në zgjedhjet e ardhshme të vitit 2024 dhe duhet të mbyllet menjëherë", tha ai.

Ai shtoi se nuk e ka menduar kurrë se "diçka e tillë mund të ndodhte në Amerikë". "Krimi i vetëm që kam kryer ka qenë mbrojtja pa frikë e vendit tonë ndaj atyre që kërkojnë ta shkatërrojnë atë", tha Trumpi. Më 4 prill, në një gjykatë në

Manhatan të Nju-Jorkut, Trumpi është deklaruar i pafajshëm lidhur me 34 akuzat për vepra penale për falsifikim të regjistrave biznesorë.

Prokurori i rastit, Alvin Bragg, tha se Trumpi i ka falsifikuar vazhdimisht këta regjistra për t'i fshehur krimet e kryera si pjesë e "komplotit për ta minuar integritetin e zgjedhjeve të vitit 2016".

Në aktakuzë thuhet se ishin bërë pagesa prej 30 mijë dhe 150 mijë dollarësh ndaj një ish-roje të Kullës Trump, i cili pretendonte se dinte një histori për një fëmijë që Trumpi e kishte jashtë martesë dhe për një grua që pretendonte se kishte një marrëdhënie seksuale me Trumpin. Akuzat u ngritën pas një hetimi

lidhur me një pagesë që ai dyshohet t'ia ketë bërë yllit të pornografisë, Stormy Daniels, në përpjekje e sipër për ta blerë heshtjen e saj, gjatë fushatës presidenciale të vitit 2016, për një aferë të supozuar.

Pagesa besohet se është kryer në mënyrë të ligjshme, mirëpo supozohet se Trumpi e ka regjistruar atë si shpenzim biznesor. Falsifikimi i regjistrave biznesorë përbën shkelje në Nju-Jork.

Gjykatësi Juan Merchan bëri me dije se seanca gjyqësore e radhës do të mbahet më 4 dhjetor të këtij viti.

Trump, 76-vjeçar, është ish-presidenti i parë amerikan që përballet me akuzat penale.

## OBSH-ja: Rreth 16 për qind e popullsisë së botës është sterile

GENEVË, 5 PRILL - Një në gjashtë persona në mbarë botën përballen me probleme steriliteti, sipas një raporti të publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) më 4 prill. Ky raport, gjithashtu, vuri në dukje se nuk ka shumë dallime në përqindjet e përhapjes së këtij fenomeni mes vendeve me të ardhura të larta, të mesme dhe të ulëta mesatare. Përqindja e të rriturve të prekur nga steriliteti gjatë jetës së tyre është 17.8 për qind në vendet me të ardhura të larta dhe 16.5 për qind në ato me të ardhura të ulëta dhe të mesme. OBSH-ja bëri thirrje për qasje më të mirë në kujdesin e fertilitetit në të gjitha vendet. Kjo organizatë e

përkufizon sterilitetin si dështim për të arritur një shtatzëni pas 12 muajve marrëdhënie seksuale të rregullt të pambrojtur.

Trajtime mjekësore dhe procedura kirurgjikale mund të përdoren për t'i ndihmuar veçanërisht gratë, ndërsa inseminimi intrauterin (IUI) ose fekondimi in vitro (IVF) janë gjithashtu opsione për çiftet që duan të bëjnë fëmijë.

OBSH-ja thotë se në shumicën e vendeve trajtimi i fertilitetit financohet nga individët dhe jo nga shërbimet shëndetësore kombëtare, gjë që mund të rezultojë në vështirësi financiare për shumë njerëz.

Sipas raportit, njerëzit në vendet më të varfra shpenzojnë një pjesë

më të madhe të të ardhurave të tyre për kujdesin e fertilitetit në krahasim me njerëzit më të pasur. Kostot e larta shihen si një nga faktorët që i pengojnë njerëzit të kenë qasje në trajtime të tilla dhe përfundimisht të mos jenë në gjendje të mbeten shtatzënë në ato raste kur metodat natyrore dështojnë. "Raporti zbulon një të vërtetë të rëndësishme - infertiliteti nuk diskriminon", tha drejtori i përgjithshëm i OBSH-së, Tedros Adhanom.

Ai shtoi se "përqindja e madhe e njerëzve të prekur tregon nevojën për ta zgjeruar qasjen në kujdesin e fertilitetit dhe për t'u siguruar që kjo çështje të mos anashkalohet më në hulumtimet dhe politikat shëndetësore ashtu që mënyra



më të sigurta, efektive dhe të prindërimin të jenë të qasshme përballueshme për të arritur për ata që i kërkojnë".

# Borrelli: Kosova dhe Serbia pajtohen për deklaratën e të pagjeturve, Kurti dhe Vuçiqi do ta miratojnë në takimin e ardhshëm

Kryediplomati evropian Josep Borell ka konfirmuar të mërkurën se shefat negociatorë të Kosovës dhe të Serbisë kanë arritur pajtueshmëri më 4 prill për deklaratën për persona të pagjetur. Në "Twitter", Borelli ka thënë se planifikohet që teksti i deklaratës për personat e pagjetur të miratohet në takimin e radhës të nivelit të lartë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**BRUKSEL, 5 PRILL** - Kosova dhe Serbia janë marrë vesh për deklaratën rreth çështjes së personave të zhdukur me dhunë. Këtë e ka bërë me dije shefi i Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, në "Twitter". Marrëveshja që ata arritën për tekstin e deklaratës për personat e pagjetur është arritur të martën në takimin e dy kryenegociatorëve, Besnik Bislimi dhe Petar Petković. "Serbia dhe Kosova janë zotuar për marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit dhe aneksin. Bashkimi Evropian pret që të dyja t'i respektojnë të gjitha obligimet dhe të fillojë zbatimin sa më shpejt. Palët duhet ta shmangin çdo përshkallëzim të mundshëm. Marrëveshja që ata arritën për tekstin e deklaratës për personat e zhdukur gjatë takimit të djeshëm të kryenegociatorëve është hapi i parë. Ne do ta miratojmë atë në

nivel liderësh në takimin e ardhshëm të nivelit të lartë...", ka shkruar Borrelli në "Twitter".

Borrelli nuk ka përmendur ndonjë datë të takimit të ardhshëm Kurti - Vuçiq, mirëpo një ditë më parë Bislimi ka thënë se takimi i nivelit të lartë mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq do të mund të zhvillohet më 22 prill.

Kurti dhe Vuçiqi janë pajtuar për marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve më 27 shkurt dhe për planin e zbatimit më 18 mars. Ndonëse ato nuk i kanë nënshkruar dokumentet, BE-ja ka thënë se marrëveshjet janë ligjrisht obliguese.

Marrëveshja me 11 nene, e bërë publike më 27 shkurt, nuk e obligon Serbinë ta njohë Kosovën, por kërkon nga të dyja vendet t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomatat dhe targat. Ajo kërkon, po ashtu, nga palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e



arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve. Në të përfshihet edhe marrëveshja për personat e

pagjetur.

Gjatë luftës në Kosovë janë vrarë rreth 13 000 njerëz, janë zhvendosur mbi 800 000, ndërsa janë zhdukur rreth 6 000.

Të zhdukur, edhe sot e kësaj dite, mbeten ende mbi 1 600 persona. Qindra trupa të shqiptarëve të vrarë të Kosovës janë gjetur në varrezat masive në Serbi.

## Presidenti i ri i Malit të Zi: Nuk ka tërheqje të njohjes së Kosovës

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Presidenti i ri i Malit të Zi, Jakov Millatoviç, tha për televizionin "Nova" se rruga evropiane e Malit të Zi është e padiskutueshme dhe se politika e jashtme - bazuar në marrëveshjet e nënshkruara ndërkombëtare - nuk do të ndryshojë.

I pyetur nga gazetarët nëse kjo do të thotë se nuk është reale të pritet tërheqja e njohjes së Kosovës, Millatoviç tha se "kjo është e qartë". "Ne mbështetim gjithçka për të cilën do të bien dakord Beogradi dhe Prishtina. Mendoj se normalizimi i marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës është i rëndësishëm për të gjitha vendet në rajon, dhe Mali i Zi dëshiron të jetë një fqinj i mirë që do të promovojë marrëdhënie të mira fqinjësore", tha ai.

Në raundin e dytë të zgjedhjeve të së dielës, më 2 prill, Millatoviçi mposhti ish-presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, duke i dhënë fund qeverisjes disadekadëshe të Partisë Demokratike të Socialistëve në Podgoricë.



Në deklaratat e mëparshme për medie ai ka konfirmuar se mbështet nismën rajonale të Ballkanit të Hapur së cilës Mali i Zi aktualisht nuk i përket.

Millatoviçi tha se beson se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është evropiane dhe se Mali i Zi mund të jetë një partner i rëndësishëm atje. "Mali i Zi


mund të luajë një rol të rëndësishëm - si një lokomotivë që mund të jetë e para që do të hyjë në BE - dhe tani t'i shtyjme, gjithashtu, të gjitha vendet e

Ballkanit Perëndimor që të na bashkohen", tha ai.

Në një intervistë për "Associated Press", ai tha se një nga prioritetet kryesore të politikës së jashtme do të jetë përshtetimi i anëtarësimit të vendit në BE dhe se shpreson që Mali i Zi të bëhet anëtar i BE-së në pesë vjetët e ardhshëm.

Millatoviç theksoi se kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për pushtimin rus të Ukrainës. "Pra, një politikë e jashtme në përputhje të plotë me atë të BE-së është ajo që duhet ta udhëheqë Mali i Zi në të ardhmen, dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme tani kur bëhet fjalë për agresionin rus në Ukrainë. Unë mendoj se në Evropë, dhe padyshim në Mal të Zi, askush nuk mund ta mbështetë pushtimin e një shteti tjetër sovran", tha ai.

Të hënën Bashkimi Evropian ka shprehur gatishmëri për të punuar me presidentin e ri të zgjedhur të Malit të Zi, duke shprehur bindjen se ky shtet do të mbetet i përkushtuar për rrugën evropiane.



MBROJTJA E JAKUP KRASNIQIT PARAQITI FJALËN HYRËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

# Mbrojtja e Krasniqit: Prokuroria s'ka prova për zëdhënësin e UÇK-së

**- Krasniqi: Në jetën time asnjëherë s'kam kryer ndonjë vepër kriminale, as para luftës, as gjatë luftës e as pas luftës**

Avokatja e Jakup Krasniqit, Venkateswari Alagendra, ka thënë se nuk ka asnjë provë që e ndërlidh zëdhënësin e UÇK-së me krimet e pretenduara nga ZPS-ja. Ajo gjatë paraqitjes së fjalës hyrëse në procesin gjyqësor në Hagë ka thënë se prokuroria e ka keqinterpretuar rolin e Krasniqit në UÇK dhe gjithë organizimin e kësaj ushtrie. Alagendra ka thënë se ZPS-ja duket sikur është bërë pjesë e propagandës kundër UÇK-së. Ndërsa Jakup Krasniqi ka deklaruar se asnjëherë në jetën e tij nuk ka kryer ndonjë vepër penale. Në këtë kontekst, Krasniqi i ka quajtur "absurde" akuzat se ai, së bashku me të akuzuarit e tjerë, kanë "persekutuar" anëtarë të LDK-së siç pretendon prokuroria

**EPOKA  
ERE**

**Lirim GECI**

**HAGË, 5 PRILL** - Në ditën e tretë të gjyqimit ndaj liderëve të UÇK-së, avokatja e ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, Venkateswari Alagendra, ka paraqitur fjalën hyrëse para trupit gjykues të Gjykatës Speciale. Me këtë rast, mbrojtja e katër drejtuesve të UÇK-së

dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) kanë përfunduar fjalët hyrëse për ta vazhduar dëgjimin e dëshmitarëve të prokurorisë. Alagendra ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nuk ka prova që e lidhin Krasniqin me krimet e pretenduara. "Provat e prokurorisë do të tregojnë rolin e vërtetë të Krasniqit. Ai nuk

kishte kompetenca dhe përgjegjësi që kërkon t'i ngarkojë ZPS-ja dhe as aktivitetet e tij nuk mund të lidhen me asnjë krim që pretendohet nga prokuroria", ka thënë ajo. Avokatja Alagendra ka thënë Krasniqi ishte emëruar zëdhënës i UÇK-së në qershor të vitit 1998 dhe të gjithë aktivitetin e ka pasur publik.

"Zëdhënësit nuk përfshihen në çështje operacionale", është shprehur ajo.

Alagendra ka thënë se Krasniqi ishte emëruar një prej dy zëvendëskomandantëve të UÇK-së për një periudhë të shkurtër kohore, por ai kishte qenë zëvendëskomandant për mbështetje dhe nuk kishte të bënte me çështje operacionale. Sa iu përket disa dokumenteve që ZPS-ja ka gjetur në shtëpinë e Krasniqit, pas arrestimit të tij, mbrojtja ka thënë se prokuroria duhet ta vërtetojë autorësinë e tyre. "Gjetja e këtyre dokumenteve në shtëpinë e tij nuk i bën autentike", ka thënë Alagendra.

Në vazhdimin e fjalës hyrëse të mbrojtjes së Jakup Krasniqit, avokatja Alagendra ka thënë se prokuroria e ka keqinterpretuar rolin e Krasniqit në UÇK dhe gjithë organizimin e kësaj ushtrie. "Ai nuk ka qenë në një marrëdhënie hierarkike me autorët fizikë të krimeve. Ai nuk kishte aftësi për të kontrolluar në mënyrë efektive ndonjë ushtar", ka thënë Alagendra. Sipas saj, prokuroria ka

dështuar ta bëjë lidhjen e krimeve të pretenduara me vendndodhjen fizike të Krasniqit nëpër periudha të ndryshme kohore gjatë vitit 1999.

Alagendra ka thënë se ZPS-ja duket sikur është bërë pjesë e propagandës kundër UÇK-së. "Provat do të tregojnë se organizimi i UÇK-së ishte i ndryshëm në vende të ndryshme dhe kohë të ndryshme", ka thënë avokatja Alagendra, duke shtuar se UÇK-ja asnjëherë nuk ka pasur një hierarki vertikale të komandës. Venkateswari Alagendra, avokatja mbrojtëse e Jakup Krasniqit, ka thënë se fakti që prokuroria insiston se në UÇK ka pasur një "ndërmarrje të përbashkët kriminale", dhe pretendimi për qëllim të përbashkët kriminal "ishte i njohur dhe publik", nuk qëndrojnë. "Kjo i bie që NATO mbështeti një ndërmarrje kriminale të njohur", ka thënë ajo, duke iu referuar bombardimeve të NATO-s që çuan në fundin e luftës në Kosovë. Ajo ka thënë se ZPS-ja

nuk ka asnjë “provë të besueshme që e lidh Krasniqin me asnjë krim. Nuk ka prova për qëllime të përbashkëta kriminale”.

### Krasniqi: Asnjëherë s'kam qenë i përfshirë në vrasje e burgosje

Pas avokates, ka folur edhe ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi. Ai ka filluar fjalimin e tij me histori personale të familjes së tij për të treguar se në çfarë rrethanash është rritur dhe pse ka vendosur ta zgjedhë këtë rrugë. Krasniqi para trupit gjykues ka folur edhe për dënimet dhe torturat që kishte përjetuar nga regjimi serb gjatë demonstratave të '81-shit. “U ushtrua dhunë e tmerrshme edhe ndaj meje. Gjatë dy proceseve hetuese që janë zhvilluar ndaj meje 81/82 kam përjetuar tmerre që s'përshkruhen me fjalë. Duart dhe këmbët i kisha gjithmonë të ënjtura nga rrahjet. Pas dy proceseve të hetuesisë më dënuan dy herë. Më 81-n me dënuan me 14 vjet burgim, në '92-n me 15 vjet burgim. I përmenda torturat që u ushtruan ndaj meje për të nënvizuar një fakt të pakontestueshëm. Asnjë hetues, asnjë prokuror dhe asnjë gjyqtar të Jugosllavisë që ishin përgjegjës për tortura psikike dhe fizike, që përjetova gjatë asaj kohe, nuk ka qenë as objekt kritike në shkrimet e

mia, i kam lënë të qetë t'i brejë ndërgjegjja për veprimet e tyre kriminale”, ka thënë Krasniqi, duke shtruar se këtë fjalim nuk po e mban për ta mbrojtur veten nga akuzat “nga njollosja që më bëhet në këtë akuzë, por për të ndriçuar atë që më duket e domosdoshme për pafajësinë time të plotë”. “Që në fëmijërinë time të hershme kam qenë i rrethuar me njerëz që i kanë mbijetuar politikës së gjenocidit serb. Nga historitë e tmerrshme që u rrëfenin më kanë bërë të kuptoj se prapa propagandës së parajsës jugosllave për barazinë e kombeve qëndronte ferri ndaj shqiptarëve”, është shprehur Krasniqi, duke treguar edhe për torturat ndaj anëtarëve të familjes së tij nga forcat serbe. “I rrahur për vdekje dhe në një qoshe nëna ime u mundonte t'ia shëronte. Përpëlitjet e tmerrshme të babait tim ende i kam përballë. Përveç torturave në fjalë, burgosja ime ishte shumë e vështirë për të. Na duhej arsimit që ta largojmë diskriminim që po përballeshim si shqiptarë në secilin segment të jetës. Por, të gjitha dijet e botës s'do të ishin të mjaftueshme për ta ndryshuar gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, pa një organizim të duhur të gjeneratës sime”, ka thënë Krasniqi.

Zëri i UÇK-së ka thënë se i urren dhunën, vrasjen dhe torturat. “Kushdo që më njeh do t'ju thotë se unë Jakup Krasniqi asnjëherë nuk kam qenë i

përfshirë në asnjë vrasje, burgosje në asnjë formë të presionit ndaj kujtdo qoftë”, ka thënë Krasniqi. Ai ka shtuar se nuk e kupton logjikën e aktakuzës së ngritur ndaj tij, duke shtuar se ndaj popullit të Kosovës është ushtruar dhunë sistematike. Në këtë kontekst, Krasniqi i ka quajtur “absurde” akuzat se ai, së bashku me të akuzuarit e tjerë, kanë “persekutuar” anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) siç pretendon prokuroria. “Është absurde që të akuzohen për persekutimin e anëtarëve të LDK-së. Unë vetë isha anëtar i LDK-së. Familjarët e mi, bashkëluftëtarët e mi, ishin anëtarë të LDK-së. Vetëm një mendje e çoroditur do të mund të mendonte se jam pjesë e persekutimit tim, të familjarëve të mi”, ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se gjatë kohës sa ka qenë zëdhënësi i UÇK-së është përpjekur që përmes deklarimeve ta mbajë shpresën te populli për ta vazhduar rezistencën për çlirim. “Në rolin tim si zëdhënësi i UÇK-së jam përpjekur të jap përshtypje se jemi një strukturë e organizuar mirë për të mbajtur shpresë te populli”, ka thënë ai. Prandaj, Krasniqi ka thënë se “deklaratat e mia duhet të shihen si pjesë e propagandës për të afirmuar luftën tonë çlirimtare”.

Më tutje, Jakup Krasniqi para trupit gjykues ka thënë se përmbajtja e aktakuzës së ngritur ndaj tij e ka “lënduar më shumë” sesa dënimet “dhe

torturat” që ka kaluar në burgjet serbe. “Unë kurrë nuk kam qenë në shërbim të ndonjë politike të kriminit. Në jetën time asnjëherë nuk kam kryer ndonjë veprë kriminale, as para luftës, as gjatë luftës e as pas luftës. Gjithmonë kam vepruar ndershmërisht për liri dhe bashkim kombëtar, që kanë qenë qëllimet e mia jetësore”, ka thënë ai.

Në fund të deklaramit të tij, Krasniqi kishte tri kërkesa për trupin gjykues: “Prokuroria i ka keqpërdorur skajshmërisht shënimet e mia. Mos lejoni që të keqpërdoren mendimet e opinionet individuale të pasluftës për kohën e luftës”, ishte kërkesa e parë e Krasniqit. Kërkesa e dytë e Krasniqit ishte që përshkrimet e librave të tij të mos përdoren si dëshmi për veprë penale. “Kërkesa e dytë: Mos lejoni që shënimet e mia, përshkrimet e librave të mia shkencore dhe publicistike, të përdoren si dëshmi për veprë penale, siç pretendon ZPS”, ka thënë ai.

Krasniqi ka përmendur edhe pjesën e komunikatave, ku i është referuar asaj se çfarë është thënë në aktgjykimet liruese për Fatmir Limajn dhe Ramush Haradinajn nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. “E treta, për komunikatat. Unë po lexoj atë që është thënë në vendimin për lirimin e Fatmir Limajt në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës: ‘Komunikatat si material propagandistik ishin rritja e respektit për UÇK-në dhe

autoritetit të saj, me qëllim që njerëzit të besonin në të dhe të anëtarësoheshin’. E njëjta gjë thuhet edhe në aktvendimin lirues për z. Ramush Haradinajn”, ka thënë Krasniqi, duke shtuar se shënimet e tij nuk mund të përdoren si dëshmi. “Ju lus që materialet të mos keqpërdoren, se unë mendoj, shënimet e mia për të shkruar libër, Prokuroria e ka keqpërdorur skajshmërisht familjen time. Ka marrë materiale të shumta, ka marrë edhe letrat e mia që i kam dërguar nga burgju, por ato nuk janë kurrfarë dëshmie për të cilat po pretendon prokuroria”, ka thënë Krasniqi.

Kujtojmë se të martën mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit kanë hedhur poshtë të gjitha akuzat ZPS-së në lidhje me udhëheqësit e UÇK-së. Ata kanë deklaruar se Thaçi, Veseli dhe Selimi janë të pafajshëm dhe se pretendimet e prokurorisë mbështeten në të pavërteta. Në këtë kontekst, mbrojtja e tyre në fjalët hyrëse ka dhënë hollësi se si ka funksionuar UÇK-ja. Para trupit gjykues, Hashim Thaçi i ka mohuar të gjitha akuzat e prokurorisë, duke thënë se viktimat nuk marrin drejtësi kur të pafajshmit ndiqen. Ai ka thënë se një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër. Ndërsa Rexhep Selimi ka thënë se nuk ka frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia. Seanca e radhës në këtë proces gjyqësor do të vazhdojë më 11 prill me fillim nga ora 9:00.



## Thellohet bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Kroacisë në fushën e produkteve dhe pajisjeve mjekësore

PRISHTINË, 5 PRILL - Kryeshefi i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Mjekësore, Sejde Tolaj, së bashku me bashkëpunëtorë, ka vizituar Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Mjekësore të Kroacisë. Ata janë pritur nga kryeshefi Sinisha Tomić dhe shefat e departamenteve të këtij institucioni. Gjatë kësaj vizite palët u morën

vesh ta shtojnë bashkëpunimin në fushën e produkteve dhe pajisjeve mjekësore duke shkëmbyer informacione mbi marketingun, kontrollin e cilësisë, farmakovigjilencën, pajisjet mjekësore etj. Po ashtu, palët u pajtuan të bashkëpunojnë ngushtë lidhur me iniciativat e reja legislative duke shkëmbyer përvojat

praktike në funksion të përafrimit të legjislacionit primar dhe sekondar lidhur me produktet dhe pajisjet mjekësore. Ekspertët e dy agjencive do të shkëmbejnë përvojat e tyre për çështjet që janë në interes të përbashkët, duke identifikuar problemet dhe ofrimin e mbështetjes reciproke për zgjidhjen e tyre.



## Përkujtohet masakra e Rezallës

Më 5 prill të vitit 1999 forca të regjimit gjenocidal të Serbisë rrethuan shtëpitë e fshatit Rezallë dhe në mënyrë mizore vranë 98 djem e burra, banorë të fshatit Rezallë dhe të fshatrave përreth. Më pas, forcat serbe kryen krimin e dytë çnjerëzor mbi ta, duke i zhdukur trupat e pajetë të 44 të vranëve

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

SKENDERAJ, 5 PRILL - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, nënkryetari i komunës, Sami Lushtaku dhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, kanë përkujtuar 24-vjetorin e masakrës së Rezallës. "Bashkë me gjeneralin Sami Lushtaku, kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, komandantë e bashkëluftëtarë të UÇK-së, familjarë dhe qytetarë të shumtë, në nderime dhe tubimin përkujtimor në 24-vjetorin e të rënëve të masakrës së Rezallës, fal gjakut të të cilëve u arrit liria e Kosovës, e më vonë edhe pavarësia e shumëpritur. Lavdi të gjithë të rënëve të masakrës së Rezallës!", ka shkruar Nura në "Facebook".

Memli Krasniqi, pasi ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial të varrezave në Rezallë, ka theksuar se para 24 vjetëve, në Rezallë të Skenderajt, forcat serbe vranë e masakruan 98 civilë shqiptarë, djem e burra të paarmatosur. "Këtë krim e bën edhe më mizor fakti që gati gjysmën e trupave i morën dhe i zhdukën, të cilët në vitin 2014 u gjetën në Rudnicë të Rashkës në Serbi. Për familjarët dhe të mbijetuarit e kësaj masakre dhembja vjen e shtohet, e për Kosovën bëhet edhe më e domosdoshme nevoja për të kërkuar drejtësi dhe ndëshkim për kryesit e këtij krimi çnjerëzor", ka thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi. Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa



Osmani, ka përkujtuar masakrën e Rezallës në 24-vjetorin e saj. "Më 5 prill të vitit 1999 forca të regjimit gjenocidal të Serbisë rrethuan shtëpitë e fshatit Rezallë dhe në mënyrë mizore vranë 98 djem e burra, banorë të fshatit Rezallë dhe të fshatrave përreth. Më pas forcat serbe kryen krimin e dytë çnjerëzor mbi ta, duke i zhdukur trupat e pajetë të 44 të vranëve. Trupat e disa të vranëve janë

gjetur kohë më pas në Rudnicë të Rashkës në Serbi", ka theksuar Osmani.

Ajo ka thënë se masakra e Rezallës dëshmoi edhe një herë tipologjinë e masakrave të kryera, të planifikuara e të udhëhequra nga forcat shtetërore serbe. "Synimi i të cilave ishin sulmet përndjekëse masive, vrasjet, dhunimet, djegia dhe shkatërrimi i pronës, deportimi i dhunshëm

dhe shfarsosja e popullatës civile shqiptare. Secili nga civilët e vranë në këtë masakër e ka historinë dhe trashëgiminë e tij. Të gjithë së bashku, ndërkaq, janë dëshmi e krimeve makabre që ka kryer Serbia në Kosovë. Ne nuk do të reshtim së kërkuari drejtësi për viktimat. Kujtim i përhershëm për to!", ka deklaruar Osmani.

Në përvjetorin e 24-t të kësaj masakre, deputetja e PDK-së,

Blerta Deliu, ka kujtuar axhën e saj Bedri Deliu dhe të gjithë të tjerët që dhanë të shtrenjtën jetë për lirinë e Kosovës. "24 vjet pa ty, njeri i urtë, fjalëpakë e trim! Do të kujtojmë sa të ketë jetë, axha Bedri, ty dhe shokët që dhanë të shtrenjtën jetë për lirinë e Kosovës. Pusho i qetë Hero, në tokën e Kosovës që aq shumë e deshe!", ka shkruar Deliu në "Facebook".

## Vitia takon kryetaren e FSSHK-së, së shpejti fillon dialogu social për kontratën kolektive

PRISHTINË, 5 PRILL - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka pritur në takim kryetaren e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Tevide Imerin dhe përfaqësuesit e FSSHK-së. Në këtë takim temë kryesore ishin kërkesat e veçanta për

infirmierë dhe për punonjësit shëndetësorë në administratë.

Të pranishmit u pajtuan në parim që sa më parë të fillojë dialogu social për kontratën kolektive, brenda së cilës do të adresohen një pjesë e madhe e kërkesave që FSSHK-

ja i paraqiti gjatë takimit.

Ministri Vitia ka thënë se do t'i adresojë të gjitha kërkesat dhe se Ministria e Shëndetësisë do ta trajtojë me seriozitet të lartë secilën kërkesë të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës.



## Mbi 4 000 aksidente ndodhën në Kosovë brenda tre muajve

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 PRILL - Policia e Kosovës në një konferencë për medie ka paraqitur raportin tremujor dhe statistikën analitike të trafikut rrugor.

Drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor në PK, Jeton Rexhepi, ofroi informacione relevante dhe raportoi lidhur me raportet dhe statistikën analitike mbi gjendjen në trafikun rrugor në Republikën e Kosovës për periudhën tremujore të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ku vërehen rënie të aksidenteve në përgjithësi. Ai ka bërë me dije se policia ka ndërmarrë shumë aktivitete që kanë të bëjnë me kontrollin e shpejtësisë, duke shtuar kështu patrullimet në terren.

Rexhepi ka shtuar se në tremujorin e këtij viti janë shënuar 4 mijë e 248 aksidente. "Në periudhën janar-mars të



këtij viti janë shënuar 4 248 aksidente, prej tyre aksidente me

fatalitet janë katër raste më pak se vitin e kaluar, rreth 18.8 për

qind sa iu përket personave të vdekur kemi katër raste më pak

apo mbi 14 për qind, sa iu përket aksidenteve me dëme kemi më pak 292 raste apo 10 për qind", ka thënë Rexhepi.

Gjithashtu, u prezantuan edhe statistika krahasuese lidhur me sigurinë rrugore në nivel rajonal për periudhën 2019-2022. Sipas raportit evropian, Kosova ka rënie për -5 për qind të aksidenteve rrugore.

Në këtë konferencë nga shefi i Zyrës për Informim major, Baki Kelani, u dhanë informacione lidhur me shpalljen e rezultateve të dy proceseve të konkurseve të fundit për zyrtarë policorë, ku në gjeneratën e radhës (58) pritet ta vijojnë trajnimin në Akademinë Policore për Siguri Publike rreth 450 kadetë.

Nënshkrimi i kontratave nga kandidatët do të bëhet gjatë këtyre dy ditëve. Po ashtu, u bë me dije se, bazuar në vlerësimet dhe nevojat policore, së shpejti pritet të hapen edhe konkurse të reja për zyrtarë policorë.

## Musliu: Organet e sigurisë kanë informacione se në Rashkë po kryhen stërvitje për ta destabilizuar veriun

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 PRILL - Në Rashkë të Serbisë po kryhen trajnime të grupeve të caktuara për ta destabilizuar situatën në Kosovë. Kështu ka deklaruar kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, pas një takimi që kanë zhvilluar të mërkurën me drejtorin e AKI-së, Petrit Ajeti. "Gjendja e sigurisë në Kosovë në përgjithësi është stabile me përfundim të katër komunave veriore ku shihen tendenca për destabilizim. E ashtuquajtura Organizata e Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim me Listën Serbe, vazhdimisht kanë aktivitet në veri të vendit. Pjesëtarë të kësaj organizate, dy grupe tashmë, janë duke kryer kurse të trajnimit në Rashkë për veprime destabilizuese në Kosovë", ka thënë Musliu.

Ajo ka theksuar se tashmë është

konfirmuar trajnimi i dy grupeve në Rashkë. "Unë flas zyrtarisht si institucion, tashmë është konfirmuar që dy grupe janë duke u stërvitur në Rashkë për aksione të ndryshme eventuale që mund të merren në veri të Kosovës. Ka stërvitje për gjuajtje me armë, stërvitje për taktizim", është shprehur Musliu.

Ajo ka shtuar se në veri po vazhdon djegia e veturave të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët kanë shprehur vullnetin t'i konvertojnë targarat në RKS. "Linçimi dhe presioni është rritur ndaj qytetarëve serbë që nuk i binden Listës Serbe në veri. Andaj si shtet dhe institucione duhet të jemi vigjilentë dhe të përgatitur për çdo provokim të situatës atje që mos të na zënë në befasi sepse nuk mund të jetë asgjë e papritur", ka deklaruar Musliu.

Deputetja e PDK-së ka shtuar se AKI-ja është duke kryer punën në terren me sukses.



## Hoxhaj për qeverinë Kurti: Çfarë ka ndodhur në këto dy vjet, ka vetëm varfërim të qytetarëve

PRISHTINË, 5 PRILL - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka folur për dyvjeçarën e qeverisjes Kurti, duke thënë se gjatë kësaj kohe qytetarët janë varfëruar dhe është rritur kostoja e jetesës. "Çfarë ka ndodhur në këto dy vjet, ka qenë varfërim i qytetarëve dhe rritje e kostove të jetesës, po ashtu edhe një izolim i jashtëm i shtetit të Kosovës. Kosova nuk ka pritje në

politikën e saj të jashtme, nuk ka avancim të agjendës së saj të integritimit evropian dhe nuk ka një hap konkret për afrim me NATO-n. Pritjet e mia kanë qenë të tilla dhe po konfirmohen", ka thënë Hoxhaj për "ABC News". Në lidhje me incidentet në veri së fundmi, ai ka thënë se këto janë akte të orkestruara nga Beogradi dhe janë një mesazh për pengimin e zbatimit të marrëveshjes së arritur në

Ohër. "Djegia e makinave në veri është një akt i orkestruar nga Beogradi. Kërkohej nga Qeveria e Kosovës të ushtrojë trysni ndaj partnerëve që të jenë të vendosur për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. E pakuptimtë që të arrihet një marrëveshje dhe ndërkohë vazhdojnë incidentet në veri të vendit. Ky ka qenë një mesazh i Serbisë për ta penguar zbatimin e marrëveshjes së Ohrit", ka thënë Hoxhaj.



## Hoti: Këta qeveritarë nuk kanë lidhje me shtet dhe me ekonomi

PRISHTINË, 5 PRILL - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se këta qeveritarë nuk kanë lidhje me shtet dhe as me ekonomi. "Këta qeveritarë lidhje me shtet nuk kanë, lidhje me ekonomi e me zhvillim nuk kanë. Bazuar në 'Raportin e buxhetit për 2022', qeveria i ka

dyfishuar pagesat avans për investime kapitale. Gjatë vitit 2022 pagesat avans kanë shkuar në 88.1 milionë euro. Në vitin 2021 kanë qenë 47.5 milionë euro, ndërsa në vitin 2020 kanë qenë vetëm 20.1 milionë euro", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka shtuar se: "Si ka mundësi

që investimet kapitale gjatë vitit 2022 dhe 2021 të jenë shumë të ulëta, ndërsa pagesat avans të dyfishohen secilin vit?! Besoj se qeveria ka shumë punë për të sqaruar arsyeshmërinë e këtyre pagesave. Ky raport i buxhetit ka plot anomalitë të tjera, të cilat do të bëhen të ditura në ditët në vijim", ka thënë Hoti.



## Kurti vizitoi kompanitë 'Pristine Original' dhe 'LB Group' në Prishtinë

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të mërkurën kompanitë "Pristine Original" dhe "LB Group" në Prishtinë. Në "Pristine Original" takoi pronarin Skerdon Pruthi bashkë me bashkëpunëtorë. E themeluar në pjesën e parë të vitit 2021, kjo kompani e dizajnit dhe prodhimit të veshjeve me kualitet të lartë tani ka gjithsej 11 punëtorë, ndërsa që produktet e saj tashmë janë shfaqur në revista ndërkombëtare prestigjioze si GQ dhe Vogue. Pas saj vizitoi "LB Group", kompani që merret me prodhimin dhe tregtimin e lëndës së ëmbëlsirave si dhe me prodhimin e ambalazheve të kartonit dhe letrës, u mirëprit nga bashkëpronari Labeatin Bajraktari dhe ekipi i tij. "Biznes familjar që punën e kishte filluar në vitin 2009, fillimisht në industrinë e paketimit me karton dhe letër,



tani ka 78 punëtorë, rroga mesatare e të cilëve është mbi 500 euro dhe është kompani lider për prodhimin lëndës së parë të ëmbëlsirave duke e zëvendësuar gjithmonë e më shumë nevojën për import për këto produkte, teksa se

fundmi ka filluar edhe prodhimin e pastës së sheqerit duke u bërë e para në vend dhe në rajon. Si rezultat i investimit në prodhim, shitjet për vetëm tre muajt e parë të këtij viti janë gati sa totali i shitjeve të krejt vitit 2020", ka

njoftuar Qeveria e Kosovës. Sipas këtij njoftimi, në vitin 2022 "LB Group" ka kontribuar me tatime gati 1 milion euro. Nga viti 2021 ajo ka edhe qendër të trajnimeve, "LB Academy", në të cilën deri më tani kanë ndjekur

trajnimet tremujore për përgatitjen e ëmbëlsirave rreth 500 gra. "Në vitin 2022 'LB Group' kishte shënuar një rritje prej 10-përqindësh në shitje krahasuar me vitin paraprak. Trend edhe më pozitiv kishte shënuar sa i përket punësimit. Për më pak se një vit e gjysmë numri i të punësuarve ishte rritur për 13 për qind. Faza e ardhshme e këtij biznesi është eksporti", është theksuar në njoftimin e qeverisë.

"LB Group" është përfutuese e dyfishtë e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, masës 2.1 - Subvencionimi i kredive investive dhe 2.4 - Mbështetja e eksportit, të cilat ua kanë mundësuar rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe zgjerimin e tregut. Kryeministri Kurti i falënderoi të dy kompanitë për angazhimin dhe kontributin e tyre për zhvillimin e prodhimitarisë vendore, promovimin e vendit përmes produkteve kualitative dhe për ekonominë e vendit.

## Kriza bankare amerikane ende nuk ka përfunduar



WASHINGTON, 5 PRILL - Kriza me të cilën përballlet sistemi bankar amerikan "nuk ka përfunduar ende", ka paralajmëruar kreu i bankës më të madhe të Shteteve të Bashkuara. Shefi ekzekutiv i JPMorgan, Jamie Dimon, i bëri komentet në një letër vjetore drejtuar aksionarëve vetëm disa javë

pas kolapsit dramatik të dy bankave të mëdha amerikane. Dimon tha se nuk priste që trazirat të çonin në një krizë botërore të ngjashme me vitin 2008, duke vënë në dukje se ajo përfshinte "më pak lojtarë dhe më pak çështje", por ai paralajmëroi se ndikimi do të zgjatej.

Dimoni tha se trazirat e fundit duhet t'i shtyjnë rregullatorët t'i shqyrtojnë rreziqet ndaj bankave që lindin nga një përqindje e lartë e depozitave të pasiguruar ose nga shumë klientë me profile të ngjashme, siç bëri SVB, e cila ishte e njohur për shërbimin e industrisë së teknologjisë.

## Sindikata e QKUK-së proteston për pakënaqësitë për koeficientin e pagave

PRISHTINË, 5 PRILL - Dhjetëra punëtorë kanë protestuar të mërkurën në ambientet e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për t'i shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me koeficientin e pagave. Sindikata e QKUK-së ka kërkuar përmirësim të gjendjes për stafin e mesëm të

administratës dhe atë mbështetës të punonjësve shëndetësorë. Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të QKUK-së, Xhemajl Selmani, ka thënë se shtesat në pagë janë hequr ose përgjysmuar. "Kapaku i pakënaqësisë është ulja e pagave të administratës së shëndetësor.

Kërkojmë përgjigje të shpejtë nga instancat menaxheriale, në veçanti nga MSh-ja", tha Selmani, duke shtuar se i kanë ndarë rrugët nga FSSHK-ja, e cila, sipas tij, me miratimin e heshtur të kësaj situatë të krijuar, e ka humbur legjitimitetin e përfaqësimit të interesave të punonjësve shëndetësorë. /Kp





AJAZ EMINI - Ditar (IX)

# NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Aty kishte një çeshme me ujë të mirë dhe shumë të ftohtë, ku i mbushëm shishet që kishim!

Pas pushimit të shkurtër që bëmë aty në kishën e fshatit, më vonë vazhduam rrugën luginës përpjetë për buzë shpatit drejtë kufirit me Maqedoninë, i cili nuk ishte aq largë. Kur u ngjitëm krejtë lartë, në majën ku ishte edhe pika kufitare Kosovë-Maqedoni, prej ku tani po shiheshin tokat dhe vendbanimet shqiptare edhe përtë kufirit, njëri nga kolegët e mijë ushtarak që kishte gallapin "Baba", i cili ishte i shtyrë në moshë dhe ishte para pensionit ushtarak, m'u drejtua mua edhe më tha: "Hej Al (Al e kisha gallapin për Albanian, sepse e kishin si të vështirë ta thonin siç duhej Ajaz) a don që të shkojmë në Llojan, nuk jemi aq largë, vijë ajrore ndoshta është rreth 8 Km.?!". Disi më habiti me këtë pyetje dhe mbeta i shokuar, neve asnjëherë nuk kishim biseduar në detaje, saktësisht se prej nga e kisha prejardhjen, i kisha tregu se jamë nga Maqedonia por jo edhe fshatin!, dhe pastaj ia ktheva: "Baba, prej nga po e din se ku është Llojani, dhe prej nga po e din se qenka fshati im i lindjes?" Baba filloi të më japë edhe pyetjet e tjera në lidhje me fshatin Llojan edhe më pyeti se: "A i njeh mësus Vaxhidin dhe mësus Alirizaun?" E shikova edhe e pieta: "Baba, kush je ti, çka je ti, si është e mundur që ti të njohësh këta njerëz, edhe mësusit dhe bashkëvendasit e mijë, prej nga i more këto informata?"

Që të gjithë që ishim aty, disi mbetëm të habitur me njohuritë e tij për fshatin tim Llojanin.

Pastaj babai vazhdoi tregimin e tij, edhe më pyeti se a kisha dëgjuar ndonjëherë edhe për forcën mbikqyrëse të paqes në Maqedoni, që quhej UNPROFOR? "Po" iu përgjigja, sepse e dija dhe i kisha parë dhe takuar shumë herë pjesëtarët e këtyre forcave ushtarake kur isha gjatë vizitave në vendlindje, në fshatin Llojan. Gjithëashtu edhe kisha biseduar me to shumë herë, ishin të nacionaliteteve të ndryshme dhe të cilët kishin një pikë të tyre qëndrimi, në mes të fshatit Llojan (të Kumanovës) dhe Miratocës (të Preshevës), si dhe tjetrën pikë në fshatin Sopot të Kumanovës, që të gjitha vendbanime me popullatë shqiptare!

UNPROFOR'i dhe UNPREDEP'i ishin një mision ushtarak ndërkombëtarë të caktuar nga Rezoluta 1142 i Këshillit të Kombeve të Bashkuara më 1992, dhe zgjati deri në gusht të vitit 1998, e që kishte për qëllim ruajtjen e paqes në rajon.

"Baba" vazhdoi tregimin e tij, se prej ku po e njihje kaqë mirë këtë rajon, edhe atë në detaje. Më tha: "Çdo herë që të ndëgjosh për ndonjë hallakamë në ndonjë shtet, aty çdo herë dërgohen grupe humanitare, por edhe vëzhguese për të ndihmuar



popullatën aty, por edhe për të vëzhguar së afërmi se ç'po ndodhë aty. Shumica e personelit prej atyre grupeve jemi edhe ne, edhe ashtu edhe mua mu dha rasti që të vijë në këtë rajon! Atje shkova me punë, por në të njëjtën kohë edhe bëra miqësi me këto njerëz të lartpërmendur. Shumë herë i bëmë vizitë këtyre fshatërave për rreth si: Llojanit, Sopotit, Tabanovcit etj. Atje mësova dhe pashë edhe diskriminimet që i bëhen shqiptarëve nga pushtetëmbajtësit maqedon, si psh: shkonim në shkollën fillore të Llojanit, dhe shihnim se aty nuk kishin kurrëfarë kushtesh elementare për mësim: si pa nxemje qendrore, pa fushë apo sallë sportive, bankat e vjetruara, kurse kur shkonim në Tabanovc te pala maqedone kushtet e mësimin ishin krejtësisht ndryshe, shumë e shumë më të volitëshme për punë se sa të shkollat e shqiptarëve!

Gjatë këtyre vizitave që po iu bënim fshatrave u njohëm shumë mirë me shumicën prej tyre, dhe i falemindrohëm pa masë fshatarëve si dhe Vaxhidit i cili sa më kujtohet ishte drejtor shkollë gjatë asajë kohe. Po, dhe Alirizaun për sjelljet shumë të mira që patën ndaj nesh!"

Pas kësajë bisede që bëmë, e cila ishte shumë interesante për mua, më shkoi mendja se si është e mundur dhe erdhi koha që tani unë po punoja me njërin prej atyre ushtarakëve që kishin punuar shumë vite më herët në vendlindjen time, e që ndoshta edhe i kisha parë dhe biseduar me to gjersa po vizitoja fshatin tim të lindjes Llojanin. Pra, shumë e shumë vite më herët! Jeta me të vërtetë, shpeshëherë është edhe tepër e çuditshme!!!

*E mërkurë 07 korrik 1999*

Ishte një ditë e bukur me diell dhe e nxehtë. Në orën 9:00 të mëngjesit u nisëm me dy makina

(Hamvee) për në Malishevë të Gjilanit, për ku na kishin lajmëruar për vendëndodhjen e një bombe. Pas arritjes në këtë fshat takuam kryetarin e fshatit Rashit Sahitin, i cili na tregoi për vendëndodhjen e asajë bombe. Me të shkuar në vendin e caktuar ku ndodhej mjeti shpërthyes, bllokuaam rrugën që mos të afrohej askush për shkak të sigurisë nga ky mjet shpërthyes, si dhe lajmëruam njësinë e Armatës Amerikane që merrej me deminime. Pas gjysëm ore njësia e deminimit arriti në vendin e ngjarjes që e kishim siguruar, të cilët mbrenda një kohe të shkurtër me mjeshtrinë e tyre bënë shpërthimin e atijë mjeti mëse shpërthyes nga një largësi rreth 100 metrash.

Aty në fshat takuam edhe Arif Rexhepin i cili ishte dëshmitarë për krimet që kishin ndodhë në Malishevë, nga i cili morëm disa informata për t'ia dorëzuar ekipeve përkatëse të UNMIK'ut që merreshin me këto punë. Zotëri Arifi siç po ndëgjonim nga fjalët e tij, ai po i njihje shumë mire edhe kryerësit e krimeve, e njihje edhe policin serb që kishte shkaktuar këto krime.

Rreth orës 11:00 para dite, nga Malisheva udhëtuam për në fshatin Uglare, një fshat me 300 shtëpi dhe me rreth 2000 banorë. Në këtë fshat takuam edhe kryetarin e fshatit Ramiz Isufin, me të cilin biseduam edhe për problemet që kishin në këtë fshat. Zotëri Ramizi na dërgoi deri në dalje të fshatit, atje ku na tregoi për rrugën që kishte mbetë e minuar nga forcat paramilitare ushtarake serbe. Pasi vizituam vendin e minuar nxorrëm koordinatat edhe lajmëruam njësinë përkatëse për deminim, të cilët mbrenda një ore erdhën edhe filluan punën e tyre të deminimit.

Deri sa njësi përkatës për deminime po bënte punën e tyre, ne vazhduam rrugën për në fshatin tjetër të quajtur Lovcë. Në këtë fshat kontaktoam me

kryetarin e këtijë vendbanimi i cili quhej Shabi Azemi, që na tregoi se fshati i tij kishte rreth 500 banorë.

Si nëpër të gjitha vendbanimet edhe këtu gjetëm shtëpitë e plaçkitura dhe të djegura nga kriminelët serbë. Sipas fjalëve të zotëri Azemit ndëgjuam se në fshatin e tij në Lovcë kishte 7 njerëz të vvarë, dhe 2 prej të cilëve edhe u ishin djegur kufomat të ndjerëve nga forcat paramilitare ushtarake serbe.

Më vonë vazhduam me udhëtimin tonë, dhe dikur vonë arritëm në fshatin Kokaj i cili gjendej në zonë kufitare me Serbinë. Në këtë zonë dolëm më tepër edhe për të parë gjendjen se si po i përmbaheshin marrëveshjes së nënshkruar nga pjesëtarët e palës serbe, pikave të veçanta të Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës, prej ku e kishin të caktuar edhe distancën se deri ku mundë t'i afroheshin kufirit të Kosovës! Gjatë bisedës me fshatarë morrëm vesh se policia serbe shpeshëherë po dilte edhe në anën Kosovare të kufirit për çka ishin mjaftë të irluar popullata lokale e këtijë rajoni.

Nga fshati Lovcë shkuaam edhe deri në fshatin Stubëll, i cili po ashtu ishte në zonën kufitare. Fshati Stubëll sipas një grupi të popullatës lokale që takuam, na njoftuan se ky fshat ka një histori të gjatë dhe të bujshme që daton nga shekulli i XV, ku në këtë fshat kishin edhe shkollën e parë në gjuhën shqipe, dikur që nga viti 1584. Në fshat vizituam edhe kishën e "Shën Gjergjit" e cila tani ishte edhe muze i shkollës së parë shqipe në Kosovë, e ku po mbahej edhe manifestimi tradicional për çdo vjet e që quhej "Takimet e Don Mikelit"! Gjatë takimit që patëm me këta njerëz, ata na bënë ftesë që të shkojmë dhe në kishën e re të fshatit ku po mbahej edhe një manifestim ditorë.

Kisha nuk ishte aq largë prej aty ku ishim, në të shkuar në kishën e

re atje takuam shumë njerëz që po festonin ditën e emërit të famulltarit të kishës. Na u lutën që të hyjmë edhe në mbrenda hollit ku po mbahej manifestimi. Pritja që na u bë aty ishte mjaftë madhështore, menjëherë na morën dhe na dërguan në sallën ku po mbahej manifestimi. Në atë sallë njoftuam edhe famulltarin për të cilin po festohej ajo ditë.

Gjithashtu në këtë manifestim takuam edhe priftin Don Anton Kqira të "Kishës Katolike Zoja Pajtores" të Detroitit në Michigan, me të cilin unë njihesha për dekada të tëra, qyshë nga koha e ardhjes sime në SHBA! Ishin fillimet e viteve të mia në SHBA, e kur çdo festë të 28 Nëntorit, "Ditës së Flamurit" unë me disa shokë shkonim nga Cleveland'i i Ohio's, rreth 2-3 orë me makinë, për ta festu në këtë kishë, sepse ata bënë organizimin më të mirë të festës në këtë pjesë të Amerikës, edhe numri i shqiptarëve në rrethin e Detroitit ishte ndoshta edhe më i madhi pas New York'ut.

Priftin Don Anton Kqira e njihja edhe si një aktivist i njohur i komunitetit shqiptar të Michiganit, i njohur gjithashtu edhe për çështjen shqiptare në ish Jugosllavi. Prifti Don Anton Kqira njihet edhe për ndihmën që organizonte komuniteti shqiptar i Michiganit, për të ndihmuar vëllezërit e tyre shqiptarë në Shqipëri, Mal të Zi dhe në Kosovë e në veçanti gjatë represaljes së neofashistit serb Millosheviqit.

*8 korrik 1999*

Disa ditë më parë i tregova Kapitenit Wiggis se nga 07 korriku do të në vijë që të na bashkangjitet në KFOR-in Amerikan edhe bashkëshortja ime Shahadija në kampin e Bondsteel'it. Kapiteni më premtoi se po sa të vijë ajo në Bondsteel ne do të shkonim menjëherë që ta takonim atë.

Në të zgjuar, pakë më vonë m'u afrua Kapiteni Wiggis edhe më tha sot do të shkojmë në kampin Boondsteel që të takohemi ti me bashkëshorten, e ne me shokët tanë të shtabit. U gëzova shumë, sepse ishte një kohë prej 4 muajsh që kur u largova nga Amerika për në Shqipëri nuk ishim parë dhe thuajse shumë pakë ishim ndëgjuar për shkak të lidhjeve jo të mira telefonike me shoqen e jetës Shahadijen.

Rreth mesditës arritëm në kampin e Bondsteel'it, mua më lanë në zyrën e TRW (TRW ishte kompania e cila ishte kontraktuesi i përkthyesve me Departamentin e Mbrojtjes së Shtetit Amerikan) që ta takoja Shahadijen, edhe më thanë se do të ktheheshin pas disa orësh që të më marrin edhe mua gjatë kthimit në vendëqëndrimin tonë në Gjilan, e kurse ata vazhduan për në Shtabin e Njësisë së Forcave Speciale. Njëri nga





# Kudusi Lama: Zëri shqiptar për drejtësi, identitet dhe dinjitet duhet të dëgjohet

*Fjalë në tubimin mbështetës të shqiptarëve për udhëheqësit e UÇK-së të ndaluar në paraburgim në Hagë, më 3 prill 2023*



Prof. Dr. Kudusi LAMA, gjeneral në pension

*Shqiptare e shqiptarë kudo që jeni,  
Të dashur motra e vëllezër të idealit kombëtar,  
Të nderuar qytetarë të Europës e botës moderne,  
Të nderuar politikanë të Europës e gjithë botës që e doni drejtësinë dhe mbarësinë e zhvillimin e popujve si të barabartë midis të barabartëve,  
Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare Zonja dhe zotërinj të Gjykatës Speciale e quajtur e Kosovës në Hagë,  
Të nderuar të pranishëm,*

E marr fjalën në këtë tubim mbarëshqiptarë këtu në Hagë për të thirrur fort përpara botës: Drejtësi! Për të kërkuar të respektohet historia për të gjithë popujt

njëlloj.

Ne jemi shqiptarë dhe jemi krenarë për përkatësinë kombëtare.

Ne jemi shqiptarë, që duam të jemi në të drejtën tonë, si gjithë të tjerët. Nuk kemi dëshirë të kemi edhe në kohët moderne, frikë se po na vrasin, se po na helmojnë, se po na burgosin, se po na masakrojnë, se po na shpërngulin, po na grabisin pasurinë, po na marrin trojet etj. Këto, jo më!

Prandaj, sot dua të thërras që të dëgjohejmë në gjithë kontinentet. Nuk mund të duroj më padrejtësinë vetëm pse të fuqishmit duan të rregullojnë interesat e tyre mbi të drejtën time. Nuk jam i gatshëm të pranoj torturën vetëm për kënaqësitë e Serbisë dhe atyre që e

përkëdhelin atë apo e kanë të preferuar ose kanë interesa. Nuk jam i gatshëm të pranoj padrejtësinë vetëm pse Serbinë dikush ka dëshirë ta kthejë në viktimitë e shqiptarët që luftuan për t'u çliruar e shpëtuar prej saj të kthehen në kriminelë.

Prandaj, jam sot këtu, për ta pyetur Europën: A të bën nder kjo lloj drejtësie? A ndihesh vërtetë e plotësuar duke akuzuar çlirimtarët për krime, për të bërë Serbinë viktimitë? A i beson vetë këto që po bën?

A vërtetë mendon Europa se progresi dhe zhvillimi arrihen duke dënuar çlirimtarët? Unë them jo, nëse Europa luftën për liri e konsideron prapambetje, ne jemi të gatshëm të mbetemi të prapambetur. Lirinë e

kemi shpallur të shenjt.

Edhe ata çlirimtarë që janë mbyllur në Hagë, kur kanë rrëmbyer armët për të luftuar pushtuesin kanë bërë betimin: Liri a vdekje. Fati i kurseu ndoshta për të mbrojtur historinë përpara përbaltësve të saj.

Unë vij këtu si një ushtar nga fusha e betejës, sepse konsideroj se sot kombi shqiptar, pikërisht këtu e ka vijën e frontit për të fituar të drejtën dhe dinjitetin politik dhe juridik në sytë e botës moderne partnerë i të cilës është.


Ne jemi qytetarë dhe e duam qytetërimin. Ne nuk duam të jemi armiq të askujt dhe nuk punojmë të bëjmë askënd armik. Por jemi të detyruar t'i sakrifikojmë të gjitha kur na cenohet drejtësia dhe

liria, kur na pushtohet atdheu e na shkatërrohet kombi.

Ne duam që në themel të lirisë të jetë ligji, i cili të bëjë drejtësi për të gjithë. Ne duam të jemi të lirë, të pa sunduar e të pa kërcënuar nga askush.

Por, kur ne dyshojmë se disa vende te Europës po na bëjnë hile, çfarë duhet të bëjmë? A mundet Europa moderne demokratike të na bindë se po bën drejtësi, kur vepron me porosi e kërkesë të masakruarit të shqiptarëve, siç është Serbia? A mundet Europa të na bindë se prokuroria Speciale në Hagë e ngritur me urdhër të Europës, e cila formalisht quhet e Kosovës, po punon për drejtësi? Pse u arratis nga detyra





Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Gjilani mposhti Llapin, Prishtina përmbysi Vushtrrinë



## "Epoka e re"

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Janë zhvilluar dy ndeshjet e para gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Skuadra e Gjilanit ka bërë një hap të madh drejt kualifikimit në finale, pasi e ka mposhtur Llapin në stadiumin "Zahir Pajaziti" me rezultat 1-2. Skuadrës mysafire i mjaftuan shtatë minuta të kalojë në epërsi me golin e realizuar nga Jashari, derisa dhjetë minuta më vonë mbrojtësi i djathtë,

Përparim Islami, është përkujdesur për rezultatin 0-2. Futbollistët vendas, edhe përkundër rezultatit, nuk janë dorëzuar dhe janë munduar të rikthehen në lojë. Në minutën e 39 Selimi e ngushtoi epërsinë në 1-2. Në pjesën e dytë Llapit tentoi ta barazojë rezultatit, por pa sukses. Gjilani iu gëzua fitores në një terren të vështirë. Finalisti vendoset në ndeshjen kthyesë që zhvillohet në Gjilan. Në ndeshjen tjetër në mes të Vushtrrisë nga Liga e Parë dhe Prishtinës, fituesi u përcaktua

në minutat e fundit. Kryeqytetasit fituan me përmbysje 1-2. Në minutën e 21-të Chibueze i kaloi vendasit në epërsi, derisa në pjesën e parë nuk pati gola të tjerë edhe përkundër përpjekjeve të kryeqytetasve për ta barazuar rezultatit. Edhe pjesa e dytë ishte dinamike, derisa Prishtina arriti ta barazojë rezultatit shtatë minuta pa përfunduar ndeshja. Autor i golit të barazimit dhe i golit të fitores ishte mesfushori Endrit Krasniqi.

## SHKURT

### Kosova sot përballlet me Poloninë

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është vendosur në qendrën olimpikë në Szczyrk të Polonisë, aty ku e zhvilloi stërvitjen e radhës nën urdhrat e selektorit Agron Shabani para ndeshjes me Poloninë. Ekipi i Kosovës ka udhëtuar të martën për në Poloni, ndërsa ndeshja do të zhvillohet sot (e enjte) nga ora 17:45 në "Bielsko-Biala". Atmosfera te "dardanet" është shumë pozitive dhe vashat janë të përkushtuara për ta dhënë maksimumin për ngjyrat e shtetit. Ndeshjet me Poloninë i takojnë fazës së dytë kualifikuese për Botërorin e këtij viti.

### Duka rizgjedhet në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, është rizgjedhur në Komitetin Ekzekutiv të qeverisë evropiane të futbollit UEFA me 45 vota, 9 vota më tepër se katër vjet më parë kur fitoi këtë post për herë të parë duke marrë më tepër vota nga të gjithë kandidatët. Ky mandat katërvjeçar në organin më të lartë të UEFA-s ka qenë pas një gare relativisht më të thjeshtë se në mandatin e parë kur ishte debutues. Në garë për anëtarët e Komitetit të ri Ekzekutiv të UEFA-s ishin njëmbëdhjetë kandidatura për tetë vende. Gjithashtu, në këtë kongres u rizgjodh për një mandat katërvjeçar edhe presidenti Alexander Ceferin i cili për këtë mandat të ri deri në vitin 2027 nuk pati garë sepse ishte kandidat i vetëm, duke u rizgjedhur me duartrokitjet e sallës.

### Kumbulla pajtohet për kontratë të re me Romën

Mediet në Itali raportojnë se është arritur marrëveshja për rinovimin e Marash Kumbullës me Romën. Mbrojtësi i kombëtares shqiptare është pjesë e skuadrës verdhekuqe prej shtatorit të vitit 2020. Kontrata aktuale i përfundon në verën e vitit 2025. Agjentët e tij po bisedojnë prej ditësh me drejtuesit e Romës dhe akordi final është arritur. 23-vjeçari, i cili fiton rreth 1.8 milion euro në sezon, do të firmosë deri në vitin 2027 me klubin kryeqytetas. Kumbulla numëron 10 ndeshje aktivizim gjatë këtij sezoni në të gjitha kompeticionet.

### Florent Hasani kushton 400 mijë euro

Florent Hasani është në qendër të merkatos. Sulmuesi kryesor i Tiranës, i cili këtë kampionat ka shënuar 16 herë në mes të Superiores, Superkupës dhe Kupës së Shqipërisë, në fund të sezonit mund të largohet nga bardheblutë. Kartoni i lojtarit vlerësohet 400 mijë euro. Ai është futbollisti më i shtrenjtë i Tiranës. Po kështu, këtë kampionat, veç 14 golave, Hasani, që është 25 vjeç, në 33 takime në kampionat ka dhënë 5 asistime si dhe ka qenë në fushën e lojës 2586 minuta. Janë disa skuadra që kanë dëshirë t'i marrin shërbimet e lojtarit të përfaqësueses së Kosovës. Mësohet se për futbollistin interesohen skuadra nga Turqia dhe Azerbajxhani. Lojtari është lider i bardhebluve këtë sezon. Ai la Hungarinë për Shqipërinë, por duket se shumë shpejt, ndoshta pas Evropës, do të prekë një aventurë evropiane.

## Veliaj, basketbollisteve të Partizanit: Krenar për lojën tuaj

**TIRANË, 5 PRILL** - Partizani është shpallur fitues i Ligës Unike në basketboll për femra. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, priti vajzat e skuadrës, të cilat i përgëzoi për titullin, sidomos në një vit kaq të veçantë, ku Tirana është Qyteti Evropian i Sportit 2023. "Jam super krenar për gocat e Partizanit dhe performancën e tyre të shkëlqyer. Në vitin që jemi

Qyteti Evropian i Sportit 2023, sjellja e një kupe në Tiranë më bën vërtet shumë të lumtur. Ndihej i shpërblyer jo vetëm për faktin se kemi kthyer vëmendjen te sporti. Më pëlqen edhe rivaliteti kur, njëherë e sjell Tirana një kupë, një herë Partizani, duke na bërë të besojmë fort tek arritjet në të ardhmen dhe sigurisht,

frymëzohet çuna e goca të vegjël që shohin e thonë: 'Ej, mund t'ia dalësh, në këtë vend mund të jesh sportist i mirë, qytetar i mirë, mund të jesh aktivist e i angazhuar'. Fakti që sot ekipi është ndërkombëtar, nga të gjithë cepat e Shqipërisë, por edhe nga cepa të ndryshëm të botës, e ka bërë vërtet kuptimplotë këtë kupë", u shpreh Veliaj.



## Fetahu dhe Dushku do të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme, Elvira Dushku, do të marrin pjesë në Asamblenë e

Përgjithshme të FIBA Evropës. Asambleja e Përgjithshme do të mbahet më 19/20 maj në Munihi të Gjermanisë. Krerët e FBK-së janë pjesëmarrës të rregullt në mbledhjet e FIBA

Evropës, ku përfaqësojnë basketbollin e Kosovës, ndërsa FIBA disa herë ka lavdëruar punën e FBK-së, sidomos në organizimet që janë mbajtur në Kosovë. Kujtojmë se Fetahu

është anëtar i Komisionit Ligjor (FIBA Europe Legal Commission) dhe Dushku anëtare në Komisionin e të Rinjve (FIBA Europe Youth Commission).



## Hamiltonit mund t'i hiqet një titull, ish-piloti i Ferrarit gati ta çojë në gjyq britanikun

**LONDËR, 5 PRILL** - Lewis Hamiltoni mori vëmendjen e botës në vitin 2008 duke fituar titullin kampion bote pas një lufte të madhe me Felipe Massan. Vetëm në xhiron e fundit të garës së fundit ishte britaniku i cili parakaloi makinat që kishte para për ta arritur vendin e pestë, gjë që i mjaftoi për ta mposhtur brazilianin. Gjithsesi duket se ky i fundit është gati të bëjë çmos për ta marrë atë titull, i cili, sipas tij, iu hoq pa të drejtë. Pika vendimtare e atij sezoni ishte përplasja e qëllimshme në Çmimin e Madh të Singaporit, kur Nelson Piket Zhunior iu tha të hynte në barriera, në mënyrë që të hynte makina e sigurisë që ndihmoi Fernando Alonso ta fitonte atë garë, ish-shokun e Hamiltonit atë sezon. Në kaos, Ferrari bëri një rrëmujë në pitstopin e Massës dhe ai përfundoi i 13-ti, ndërsa Hamiltoni ishte i treti, duke i dhënë atij një grumbull të madh pikësh. Ndërsa shpresat e brazilianit për ta përmbytur rezultatin fillimisht u zbehën, ai tani po kërkon opsionet e tij ligjore pas vërejtjeve nga ish-lideri "suprem" i Formulës 1, Bernie Ecclestone. Në një intervistë të dhënë online, Ecclestone ka



thënë: "Ne vendosëm mos të bënim asgjë tani për tani. Ne donim ta mbronim sportin dhe ta shpëtonim atë nga një skandal i madh. Kjo është arsyeja pse përdora gjuhë engjëllorë për ta bindur Nelson Piket që ta ruante qetësinë për momentin. Në atë kohë ekzistonte një rregull që klasifikimi i kampionatit pas ceremonisë së dhënies së çmimeve të FIA-s ishte i paprekshëm. Kështu që Hamiltonit iu dha trofeu dhe gjithçka ishte në rregull. Ne kishim informacion të mjaftueshëm në kohë për ta hetuar çështjen. Sipas statutit, ne duhet ta anulonim garën e Singaporit në ato kushte. Kjo do të thoshte se nuk do të ndodhte kurrë dhe atëherë Felipe Massa do të shpallej kampion bote dhe jo Luis Hamiltoni". Braziliani tani kërkon t'i eksplorojë opsionet e tij pas

bombës së 92-vjeçarit, me anë të një lëvizje gjyqësore që mund ta shohë Hamiltonin të zhveshur nga titulli i parë. Në një intervistë për "Motorsport.com", Masa ka thënë: "Ka një rregull që thotë se kur vendoset një kampionat, që nga momenti që shoferi merr trofeun e kampionatit, gjërat nuk mund të ndryshojnë më, edhe nëse është vërtetuar një vjedhje. Në atë kohë, avokatët e Ferrarit më thanë për këtë rregull. Ne shkuam te avokatët të tjerë dhe përgjigjja ishte se nuk mund të bëhej asgjë. Kështu që unë besoj logjikisht në këtë situatë. Por pas 15 vjetësh dëgjim që ish-pronari i kategorisë thotë se e ka marrë vesh në vitin 2008, bashkë me presidentin e FIA-s dhe nuk kanë bërë asgjë për të mos e njollësuar emrin e F1. Kjo është shumë e trishtueshme, se rezultati i kësaj gare supozohet të anulohet dhe unë do të kisha një titull. Në fund kam qenë ai që kam humbur më shumë me këtë rezultat. Pra, po shkojmë pas për t'i kuptuar të gjitha këto", u shpreh braziliani. Massa e pranon se shanset e tij për ta përmbytur rezultatin janë të pakta, por do të vazhdojë të hetojë deri në momentin e fundit.

## Milwaukee i pari në Lindje, fitojnë edhe Lakersi, Warriorsi e Phoenixi

**WASHINGTON, 5 PRILL** - Thuajse të gjitha ekipet e NBA-s kanë zbritur në fushë, teksa janë luajtur 13 ndeshje. Ekipi i Milwaukee fitoi me rezultat 140-128 ndaj Washingtonit, duke mbrojtur kreun e renditjes në Lindje. Antetokounmpo, protagonist me një "triple double" (28 pikë, 11 rebounde, 10 asistime). Fitorja e katërt radhazi për Lakersat, që pas kohës shtesë mundën me rezultat 135-133 Utah Jazzin. U dallua LeBron Jamesi, autor i 37 pikëve, mbështetur nga Reaves me 28 pikë. Fitoi edhe Philadelphia, që mundi me rezultat 103-101 rivalët e Bostonit në Lindje. Joel Embiid ishte i jashtëzakonshëm, autor i 52



pikëve e 13 reboundeve për fituesit. Zhgënjeu sërish Denveri, që u mund me rezultat 124-103 nga Houstoni. Për Houstonin, shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, përfshi titullarët (Jalen Green 32 pikë). Skuadra kampione e Golden States, falë 34 pikëve të Curryt dhe

30 të Pooles, mundi me rezultat 136-125 Oklahoman, ndërsa Phoenixi mundi me rezultat 115-94 San Antonion (Booker 27 pikë).

### REZULTATET

Charlotte - Toronto	100-120
Detroit - Miami	105-118
Orlando - Cleveland	113-117
Washington - Milwaukee	128-140
Brooklyn - Minnesota	102-107
Chicago - Atlanta	105-123
Houston - Denver	124-103
Memphis - Portland	119-109
New Orleans - Sacramento	103-121
Philadelphia - Boston	103-101
Utah Jazz - Lakers	133-135
Golden State - Oklahoma	136-125
Phoenix - San Antonio	115-94

### SHKURT

#### Ceferin rizgjedhet në krye të UEFA-s

Aleksander Ceferin konfirmohet në krye të UEFA-s edhe për katër vjetet e ardhshme. Sloveni, i cili mban postin e presidentit të UEFA-s prej vitit 2016, fitoi sot mandatin e tretë në krye të qeverisë evropiane të futbollit. Kongresi i 47 i UEFA-s mbledhi së bashku në Lisbonë presidentët dhe sekretarët e përgjithshëm të 55 shoqatave anëtare të UEFA-s për të marrë vendime që ndihmojnë në formësimin e futbollit evropian. Ceferin nuk kishte asnjë kandidat përballë, ndaj dhe votimi për rizgjedhjen e tij ishte thjesht formalitet. "Dua t'ju falënderoj nga thellësia e zemrës për mbështetjen. Është nder dhe përgjegjësi e madhe kjo detyrë. Dua t'ju premtoj se do të jam më të mirën time për të mos ju zhgënjyer juve dhe futbollin", ka deklaruar 55-vjeçari.

#### Leclerc: Objektivi im është ta kaloj vijën e finishit

Charles Leclerc e ka nisur sezonin në mënyrën më të keqe të mundshme. Vetëm gjashtë pikë në klasifikim dhe dy tërheqje nga tri gara të mbajtura deri më tani janë një sinjal i qartë se ky edicion do të jetë i vështirë për të dhe Ferrarin. "Është padyshim starti më i keq në jetën time. Jam shumë i inatosur. Jam me vetëm gjashtë pikë në klasifikim. Tani nuk mendoj shumë për atë që mund të ofrojë sezoni në të ardhmen. Objektivi im kryesor për garat e radhës është të përfundoj garën dhe ta kaloj vijën e finishit pa pasur penalizim apo ndonjë aksident. Më pas ideja është të përfitojmë nga momenti i mirë dhe të shohim para", u shpreh Leclerc.

#### Tuchel: Kërkohet reflektim rekord

Bayern Muncheni u eliminua nga Kupa e Gjermanisë pasi pësoi humbje nga Freiburg. Pavarësisht asaj se Thomas Tuchel erdhi si shpëtimtar në Bayern dhe për ta fituar "tripletën" e madhe, tekniku gjerman zbrit me këmbë në tokë që në ndeshjen e dytë. Tucheli pas eliminimit nga Kupa ka kërkuar të ketë reflektim në kohë rekord. "Jam shumë i zhgënjyer që nuk arritëm ta dërgonim topin në kuadrat në tentativa flagrante. Nuk ka rëndësi nëse e merituar eliminimin apo jo, ne jemi jashtë dhe ky komponent nuk ndryshohet pavarësisht prej diskutimeve. Gabimet na shoqëruan përgjatë gjithë lojës, arsyeja e fortë se përse kërkohet reflektimi në kohë rekord", ka thënë Tuchel.

#### Inzaghi: Do të japim gjithçka për të shkuar në finale

Skuadra e Interit barazoi ndaj Juventusit (1-1) në gjysmëfinalen e parë të Kupës së Italisë. Trajneri Simone Inzaghi vlerësoi performancën e skuadrës së tij teksa premtoi maksimumin në ndeshjen e kthimit që do të luhet më 26 prill në "San Siro" për të arritur në finale të Kupës. "Më pëlqeu reagimi i skuadrës. Djemtë zhvilluan një ndeshje të madhe në një fushë të vështirë. U përballëm me një skuadër që po rritet dita-ditës. E kontrolluam pjesën më të madhe të ndeshjes, ishim ne ata që komanduam lojën. Djemtë më dhuruan përgjigjen që prisja. Do të japim gjithçka në sfidën e kthimit për ta siguruar kualifikimin në finale", ka thënë Inzaghi.

## Muguruza tërhiqet përkohësisht: S'do të luaj asnjë ndeshje deri në korrik

Tenistja spanjolle Garbine Muguruza, ish-numri 1 në botë dhe fituese e dy grand slameve në karrierën e saj, ka vendosur të mos luajë në asnjë nga turnetë që do të zhvillohen muajt në vazhdim në fushat me dhe e ato me bar. Pra, ajo s'do të luajë deri në korrik, kur dhe

mbyllet grand slami i Wimbledonit. Ndeshja e saj e fundit daton më 30 janar të këtij viti. "Po kaloj më shumë kohë me familjen dhe miqtë. Këto kohë me familjen kanë qenë shumë të rëndësishme e të nevojshme për mua, ndaj do ta shtyj këtë periudhë jashtë

fushave deri në verë. Pra, s'do të luaj në fushat me dhe e ato me bar", ka thënë Muguruza, aktualisht jashtë "top-100". Me shuma gjasë, tenistja 29-vjeçare, numri 1 në botë në vitin 2017, nuk do të luajë edhe në dy grand slam që ka fituar, Roland Garros (2016) e Wimbledon

(2017). Ajo pritet të kthehet në fushë në turnetë Masters të Amerikës së Veriut ose në US Open. Muguruza nuk luajti as në turnetë Masters të Indian Wells e Majemi muajin e fundit. "Do të marr një pushim të gjatë nga të gjitha veprimtaritë. Vetëm kur të ndihem gati do të

rikthehem të luaj, ndërkohë që do të vijoj të stërvitem me skuadrën time. Vjet vura shumë presion mbi veten time. Në këtë moment të karrierës, renditja nuk ka më rëndësi për mua", ka deklaruar Muguruza për "Marca", që vjet zhgënjeu pasi fitoi në vitin 2021 WTA Finals.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr.464/01-53706  
Datë: 29.03.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

**I. MIRATOHET** shpronësimi i pronave të paluajtshme, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik për ndërtimin e parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, të Njesisë kadastrale 0-71409044-01740-1 me kulturë arë c.kl.I me sipërfaqe prej 433 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Lipjan në emër të Shaban Osman Reçica nga Lipjani.

**II.** Pjesë e këtij Vendimi është Akti i Vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

**III.** Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë të Republikës së Kosovës të datës 13.02.2023.

**IV.** Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Ineredit në pronë ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 datë.28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

Page 1 of 2

**V.** Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Infrastruktura.

**VI.** Ky vendim paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

**VII.** Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi i'u dërgohet:

- Shaban Osman Reçica
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Infrastruktura
- Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDENNIK OPŠTINE

01Br.464/01-53706  
Dana: 29.03.2023

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 11 zakona Br.03/L-139 Ekspropriaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Br.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

ZAVRŠNU ODLUKU

**I. USVAJA SE** ekspropriacija nepokretne imovine za izgradnju centralnog gradskog parka i podzemnog parkinga u Lipljanu, Katastarska Jedinica 0-71409044-01740-1 Njiva kl.1 površina od 433 m<sup>2</sup> Katastarska Zona u Lipljanu na ime Shaban Osman Reçica iz Lipljana.

**II.** De ove Odluke akat procenjivanja u kojem je određen iznos kompenziranja za one vlasnike ili imalaca interesa, pravo vlasništva ili zakonskih interesa kojima je dotaknulo imanje u procesu ekspropriacije.

**III.** Od dana stupanja na snazi ove Odluke, obavezuje se Direktor za Budžet i Financije, da u roku od dve (2) godine isplati u celini iznos kompezacije eksproprisane imanje određene prema izveštaju procenjivanja Kancelarije Procenjivanja Nepokretne Imanja u okviru Ministarstva Financije- Departament za Poreza na Imovino Republike Kosova dt.13.02.2023.

**IV.** Protiv ove Odluke unutar trideset (30) kalendariskih dana nakon stupanja na snazi, imaju pravo da podnesu žalbu u Osnovni Sud Priština-ogranak Lipljan svako lice je vlasnik ili vlasnik interesa ili pravo vlasništvo dodatnute, kao svako zainteresovano lice ima neki direktan materialni interes u nepokretnu imovinu, nezavisno ako nije identifikovan ili ne u Odluci ,za protivljenju iznos kompenzacije u skladu sa članom 36 i 37 Zakona Br.03/L-139 za Ekspropriaciju Nepokretne Imovine sa dopunama i promenama Zakona Br.03/1-205 dt.28 Oktobar 2010 (Službene Novine Republike Kosova Br.91).

Page 1 of 2

**V.** Za sprovođenje ove Odluke obavezuje se kancelarija Predsednika-Pravno Imovinski Sektor, Direktor za Planiranje, Urbanizma i Zaštite Sredine, Direktor za Budžet i Financije, Direktor za Geodezije i Katastar, Direktor za javnih Usluga, Zaštite Ispašavanja i Direktor za Infrastrukturu.

**VI.** Ova Odluka predstavlja pravni osnov za upisivanje u katastarskim knjigama na ime novih vlasnika tehničke podele katastarskih parcela. Sa stupanjem na snazi ove Odluke, Direktor za Geodeziju i Katastar je obavezan da obavlja proceduralne i tehničke postupke za njegovo sprovođenje.

**VII.** Završna Odluka stupa na snazi dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanju u neku novinu sa većim tiražom na Kosovo.

Odluka dostaviti:

- Shaban Osman Reçica
- Direktoratu Planiranja Urbanizma i Zaštite Sredine
- Direktoratu za Budžet i Financije
- Direktoratu Geodezije i Katastra
- Direktoratu Javnih Usluga, Zaštite Ispašavanja
- Direktor za Infrastrukturu.
- Arhivi Opštine

PRESDENNIK OPŠTINE  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr.464/01-53706  
Datë: 29.03.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

